

REPUBLIKA E HQIPERISE

NOTERE MAJLINDA E. DEMOLLARI

Nr 3091 Rep

Nr 1999 Kol

*Majlinda E. Demollari
Taksor e Pulles
U Paqua*



AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ HRCP.company ” shpk

Ne Tirane, sot me 11/06/2018 (dymije e tetemdhjete), para meje Noteres Majlinda E. Demollari, anetare e Dhomes/se Notereve Tirane ne Rr” Vaso Pasha” , u paraqiten personalisht :

Gerilda Haderi, lindur me 18.06.1990, lindur ne Sarande dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, e identifikuar me pashaporte me nr. BJ2893934.

Mirgen Zaçellari, lindur me 15.09.1982, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pashaporte me nr. BA3477022.

Ne cilesine e ortakeve te shoqerise Shpk te cilet kane vendosur te miratojne dhe te neshkruajne statutin ne perputhje me kushtet si me poshte:

EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA

NENI 1. –

EMËRTIMI I SHOQËRISË

1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ HRCP .company” shpk me poshtë e quajtur “Shoqëria”.

NENI 2. –

SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr “ Kavajes ” pall 123, kati i dyte Tirane Shqiperi.

Më vendim të organit administrativ Shoqëria mund të hape ose të mbylle zyra përfaqësie, degë, dhe/ose të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3. –

KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të papërcaktuar, duke nisur nga regjistrimi i saj pranë Regjistrat Tregtar.

NENI 4. –

OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt:

Prodhim produktesh letre dhe kartoni për ambalazhimin, kuti kartoni bikerina etj
Veprimtari në fushën e bimeve medicinale, prodhim ambalazhim dhe tregëtim sipas ligjit, eksport import etj.

KAPITALI – PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

NENI 5. –

KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 100.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre me mëposhtme:
Ortaket themelues ;

- **Mirgen Zaçellari**, zotërues i një kuote të kapitalit, me vlerë të përgjithshme 51,000 leke, që përbejnë 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë
- **Gerilda Haderi**, zotërues i një kuote të kapitalit, me vlerë të përgjithshme 49,000 leke, që përbejnë 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakeve mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme, të paluajtshme ose të drejta)

NENI 6-

ZMADHIMI I KAPITALIT

6.1. Kapitali themeltar mund të zmadhohet me vendim të ortakeve, në përputhje me mënyrën dhe afatet për këtë zmadhim.

6.2. Në rast zmadhimi i kapitalit, ortaket kanë të drejtën e parapëlqimit dhaj shumava të emetuara rishtazi. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet nga ortaket brenda 30 ditëve në raport me kuotat e kuotave që kanë në zotërim.



6.3 Ortaket qe ushtojne te drejten e parapëlqimit kur bejne kerkese per ushtrimin e saj, kane te drejte parablerjeje per kuotat e parapëlqyera.

6.4 Cdo Ortak zoteron te drejten te parableje nje numer me te vogel kuotash, pas aprovimit te Asamblesë se Ortakeve.

NENI 7-

ZVOGLIMI I KAPITALIT

7.1. Zvoglimi i kapitalit mund te kryhet, ne perputhje me ligjin shqiptar per shoqerite tregtare.

7.2 Zvoglimi i kapitalit nuk mund te behet nen minimumin e parashikuar ne ligj.

NENI 8. -

SHITJA E KUOTAVE

8.1. Ne perputhje me kufinje dhe kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar, shitja e kuaotave te kapitalit themelor i nenshtrohet ne cdo rast te drejtes se parablerjes nga ana e ortkeve te tjere.

8.2 Per kete arsye, ortaket duhet te vene ne dijeni ortaket e tjere me leter rekomande me pergjigje, duke percaktuar shumen e ofruar dhe kushtet e pageses dhe emrin e bleresit.

8.3 Brenda 30 (tridhjte) ditesh nga marrja e letres, ortaket e tjere mund te vendosin te blejne kuoten qe eshte ne shitje duke informuar shitesin mbi vendimin e tyre. Nese te drejten e parablerjes deshiron ta ushtroje me shume se nje ortak, secili do te realizoje blerje ne perpjestim me kuoten qe zoteron.

8.4 Kur bleresi nuk merr njoftim brenda tridhjte diteve, atehere do te kuptohet se eshte hequr dore nga e drejta e parablerjes.

8.5 E drejta e parablerjes nuk mund te ushtohet ne rastet e shitjes se kuotave nga nje ortak tek nje tjetër.

NENI 9. -

ORTAKET

9.1 Ortaket e Shoqerise jane :

Gerilda Haderi, lindur me 18.06.1990, lindur ne Sarande dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, e identifikuar me pashaporte me nr. BJ2893934.

Mirgen Zaçellari, lindur me 15.09.1982, lindur ne Korce dhe banues ne Tirane, madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pashaporte me nr. BA3477022.

9.2 Ortaket , në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime ne lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, (iii) transferimin te te tretet e pjesëve te kapitalit te Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si dhe me emërimin e shkarkimin e ekspertit(eve) kontabël te autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor te Shoqërisë si dhe te çdo raporti tjetër financiar, (vi) shpërndarjen e likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit (eve) e çdo vendim tjetër qe sipas ligjit apo këtij statuti i takon Asamblese se Ortakeve.

NENI 10-

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

1. Funksioni dhe Pergjegjesite.

Asambleja e Ortakeve do te mblidhet duke respektuar ligjin shqiptar per shoqerite tregtare dhe secili nga keto vendime do te respektoje statutin e shoqerise . ne lidhje me administrimin, marredheniet me shoqeri te tjea, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit trasferimin e kuotave, per emerimin dhe zevendesimin e Administratorit dhe Personave te Autorizuar, aprovimin e bilancit te parashtuar nga Administratori , shit-berjen e aseteteve te shoqerise si dhe cdo vendim tjetet I cili duhet ti parashtohet Asamblese se Ortakeve.

2. Mbledhja vjetore e Asamblese.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor .Ne kete mbledhje te Asamblese do te aprovohen nga ortaket raporti financiar I bilancit I aprovuar nga Administraori mund te vendosi edhe ceshtje te tjera te parashikuara. Mbledhjet e Asamblese mund mbahet me conference-call.


3. Asambleja.

Asambleja e Ortakeve mund te mblidhet ne menyre te rregullt, sic parashikohet ne dispozitat ligjire nga Administratori apo ne mungese te tij nga nje Auditor i Autorizuar si dhe me kerkesen e: nje apo disa ortakeve qe perfaqesojne 10% te pjeseve te kapitalit te shoqerise.

4. Vendi I Asamblese.

Asmbleja mund te mblidhet ne vendi e caktuar nga Ortaket dhe nese nuk do te percaktohet nje vend tjetet, vendi ku do te mblidhet Asamblehja do te jete selia e shoqerise.

5. Njoftimi I Asamblese.



Administratori iu njofton te gjithë ortakeve, Mbledhjen e Asamblese, me leter rekomande, te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Lajmerimi permban daten, adresen e vendtakimit dhe rendin e dites se Mbledhjes. Njoftimi do te behet ne adresen e regjistruar ne Statut (Neni 5), nese Ortaku nuk ka deklaruar nje adrese te re.

6. Vendimi I Asamblese se Pergjithshme

Asambleja merr vendim me shumice te zakonshme ne rast se nuk do te kerkohet ndryshe ne kete Statut apo ne ligji. Ne rast se shumica e zakonshme eshte e kerkuar, nuk eshte e pranishme, Asambleja do te vendosi nje tjeter date per mbledhjen e saj. Njoftimet do te behen sipas paragrafit 5 te ketij Neni. Ne mbledhjen e dyte te thirrur Vendimet do te jene te vlefshme vetem me shumicen e votave te Ortakeve qe perfaqesojne totalin e kapitalit, me perjashtim te rasteve kur kerkohet nje votim i ndryshem ne Statut apo ne ligj.

7. Autorizimi.

Ortaket mund te Autorizojne me shkrim nje person tjeter per te votuar ne vend te tij duke perfaqesuar kuotat e poseduara prej tij. Kryetari I mbledhjes do te jete pergjegjes per tu informuar ne lidhje me rregullsine e autorizimit dhe te drejtes te qene I pranishem ne mbledhjen e Asamblese.

8. Pranimi me shkrim.

Procesverbalet e mbledhjes se Asamblese se Ortakeve , do te jete ne gjuhen shqipe dhe ate anglese.

NENI 11. –

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

11.1 Shoqëria administrohet nga 1 (nj) Administrator Mirgen Zaçellari me nje afat 2 vjecar .

11.2 Ne zbatim te këtij neni, administratoret përfaqësojne Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratoret kane gjithashtu të drejte të nënshkruajnë pa asnjë kufizim kontrata të ndryshme në emër e për llogari te Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajnë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak si dhe ndryshimin e statutit te tyre, të nënshkruajnë e hartojnë çdo dokument e të kryejnë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo te huaja në lidhje



me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejnë veprime tërheqjeje e derdhje shumash nga këto llogari vec e vec dhe pa limit.

11.3 Administratoret mund të ndërmarrin apo kërkojnë kryerjen e të gjitha akteve që i konsiderojnë të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

11.4 Administratori emërohet për një periudhë kohore 2 vjecare, me të drejte ripërtëritjeje, dhe janë përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë.

NENI 12. –

12.1 Administratoreve u takon t'u paguhen shpenzimet e bera për shkaqe të detyres së tij.

12.2 Asambleja mund t'u njohe atyre një kompensim vjetor.

NENI 13. –

13.1 Administratoreve apo Drejtori i Përgjithshëm nëse është i emeruar, do të përfaqësojë shoqërinë me palet e treta gjatë gjykimeve, ka të drejtën e emerimit të avokateve, juristeve, në kufinj të përgjegjesive të lejuara.

NENI 14. –

KONTROLLI KONTABËL

14.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Ortakëve do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

NENI 15. –

FINANCIMI I SHOQËRISË

15.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga Asambleja e Ortakëve financime të mëtejshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, të ndryshme nga zmadhimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë.

15.2 Financimet e mëtejshme të Asamblesë së Ortakëve do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

15.3 Asambleja ka të drejtë të vendosi në çdo kohë të vendosë në lidhje me rezervat dhe sasine të tyre.

VITI FINANCIAR DHE BILANCI



**NENI 16. –
VITI FINANCIAR**

16.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përveç vitit të parë, i cili fillon nga data e regjistrimit dhe mbaron në fund të vitit.

**NENI 17
LLOGARITE VJETORE**

17.1. Llogarite vjetore, raporte mbi operacionet e veprimtarisë lidhur me vitin financiar dhe raportet e veçuara të hartuara nga administratori dhe nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja me shumicën e zakonshme.

17.2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore të shoqërisë bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes së vitit financiar.

**NENI 18-
FITIMI**

18.1. Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha shpenzimet, si edhe fondet e lene reserve për nxitje ekonomike, për investime për reklame tregtare, ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me përqindjen e kapitalit themeltar që ka secili ortak.

18.2. Ortaket e huaj, mund të transferojnë lirisht fitimet e realizuara jashtë shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare në fuqi.

**NENI 19
BILANCI**

19.1 Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 marsit të vitit pasardhës.

PRISHJA E SHOQËRISE DHE LIKUIDIMI

**NENI 20-
LIKUIDIMI**

20.1. Shoqëria priset me vendim të asamblese me shumicë të jashtëzakonshme dhe në përputhje me ligjet në Republikën e Shqipërisë.

20.2. Shoqëria duhet të kryejë procesin e likuidimit në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.



20.3. Mbas pagimit te kreditoreve, shlyerjen e te gjithë detyrimeve dhe shlyerjen e pjeseve te kapitalit themeltar tek kotribuesit perkates, likujduesi ndan kapitaret e mbetura ndermjet ortakeve propocianlisht me pjeset qe ate zoterojne.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 21-

KONFLIKTET

Te gjitha mosmarreshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te shqyrtohen nga gjykata e rrethit Tirane.

Ky Statut u firmos ne kater kopie ne Shqip dhe kater kopie me te njejten permbajte me vullnetin e tyre te plote e te lire, e nënshkruajne rregullisht ne praninë time dhe unë Noteri vërtetoj këtë dokument sipas ligjit.

ORTAKET

Mirgen Fazellari

Corinda Hoxha



NOTERE

Maftinda E. Demollari

NP7: 2414000004

Tel: 0682461358

